



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e gjuhës shqipe dhe e letërsisë

Faza II

Viti shkollor 2015-2016

Klasa 11

2 prill 2015

Kjo skemë vlerësimi është orientuese.

Përgjigjet e nxënësve do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e dhëna më poshtë. Secili kriter ka një total pikësh. Nxënësi duhet të shfaqë disa kompetenca për secilin kriter, të cilat qartësohen në tabelën përkatëse. Kjo tabelë shpreh në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbushë nxënësi për të marrë pikë të plota apo ndërmjetëse.

1. “Vështirësitë e jetës janë prova më e mirë për personazhet”.

Analizoni mënyrat me të cilat personazhet janë paraqitur në dy vepra që keni studiuar dhe vlerësoni nëse është i drejtë ky pohim.

20 pikë

Rubrikat e vlerësimit

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim).
-Zhvillon idetë, duke përdorur detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **5 pikë**
- II. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **5 pikë**
- III. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t’ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **5 pikë**
- IV. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe. **5 pikë**

2. Nuk është gjithmonë e lehtë të marrësh anën e mirë, madje ndonjëherë është e rrezikshme.

Përshkruani një moment në jetën tuaj, kur ju e vendosët veten tuaj në rrezik (emocional, psikologjik apo fizik) për të bërë atë që ju mendonit se ishte e drejtë.

15 pikë

Rubrikat e vlerësimit

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe mban një pozicion të shprehur qartë. **3 pikë**
- II. Zhvillimi i ideve:** përgjigjja e dhënë përdorur detaje specifike, shembuj, ilustrime, të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**

3. Konflikti midis personazheve, ideve apo ndonjë aspekti tjetër të veprës është një nga mënyrat themelore për të tërhequr vëmendjen e lexuesve.

Duke u bazuar në të paktën dy vepra që keni studiuar, argumentoni se si dhe deri në çfarë shkalle mendoni se kjo thënie është e vërtetë.

15 pikë

Rubrikat e vlerësimi

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e këngëve të marra në shqyrtim). **3 pikë**
- II. Zhvillimi:** përgjigjja e dhënë përdor detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes nga teksti ose tekstet e marra në shqyrtim. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**